

Në bazë të nenit 164, 165, 166, 172 dhe 182 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 82/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.178/21), nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 62/2005; 106/2008; 161/2008; 114/2009; 130/2009; 149/2009; 50/2010; 52/2010; 124/2010; 47/2011; 11/2012; 39/2012; 13/2013; 25/2013; 170/2013; 187/2013; 113/2014; 20/2015; 33/2015; 72/2015; 129/2015; 27/2016, 120/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.110/19, 267/20, 151/21, 288/21 dhe 111/23), Rregullores për kriteriumet e posaçme dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, mësimore - profesionale, shkencore, mësimore dhe për thirje në bashkëpunëtor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup, Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, shpall:

## KONKURS

**Për zgjedhje të personave në të gjitha thirrjet mësimore shkencore dhe thirrje akademike (thirrje të titulluar) pranë Fakulteteve të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup**

### A. FAKULTETI JURIDIK

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore shkencore nga fusha mësimore – shkencore – **E drejta penale**

### B. FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNOLOGJIKE

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha thirrjet mësimore shkencore nga fusha mësimore – shkencore – **Mikrobiologjia teknologjike dhe Teknologjia e mishit dhe përpunimit të mishit**

### B. FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE

1. Zgjedhje të një një personi në thirrje akademike (thirrje të titulluar) nga fusha mësimore – shkencore – **Marrëdhënie ndërkombëtare dhe historia e diplomacisë**
2. Zgjedhje të një një personi në thirrje akademike (thirrje të titulluar) nga fusha mësimore – shkencore – **Shkenca e menaxhimit**
3. Zgjedhje të një një personi në thirrje akademike (thirrje të titulluar) nga fusha mësimore – shkencore – **Organizatrat politike ndërkombëtare dhe diplomaci**

### Kushtet dhe kriteriumet për zgjedhje:

Kandidatët duhet të plotësojnë e kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedone,
- Të jetë në moshë madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Të mos ketë vendim gjyqësor të plotëfuqishëm me dënim ndalesë të kryerjes së profesionit veprimit apo detyrës.

Përpos plotësimit të kushteve të përgjithshme të lartpërmendura, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet dhe kriteriumet të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteriumet e posaçme dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore – shkencore, mësimore - profesionale, shkencore, mësimore dhe për thirje në bashkëpunëtor në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

### Kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitje për konkurim,
- Biografi të shkurtë-CV,
- Certifikatën e shtetësisë,
- Vërtetim për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës – Vërtetim mjekësor,
- Vërtetim se nuk ka vendim gjyqësor të plotëfuqishëm me dënim ndalesë të kryerjes së profesionit veprimit apo detyrës,
- Dëshmi për njohje të njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin European (angleze, frënge, gjermane),

- Diplomën dhe certifikatën e notave për të tre ciklet e përfunduara të studimit (nëse arsimi është kryer jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut të bashkangjitet dëshmia për nostrifikim dhe ekuivalenca e notave),
- Listë me punimet shkencore dhe profesionale dhe nga një egzemplar të punimeve shkencore dhe profesionale si dhe
- Vendim për përzgjedhje të mëparshme në thirrje mësimoro-shkencore (nëse posedon).

Orari i punës do të përcaktohet në përputhje me orarin e orëve mësimore dhe akteve të Universitetit.

Shuma e pagës bazë neto për mësimdhënës është në përputhje me aktet e Universitetit dhe është 53.113 denarë.

Shuma e pagës bazë neto për thirrje akademike (thirrje të titulluar) është në përputhje me aktet e Universitetit, angazhimin mësimor të mësimdhënësit në semestër dhe titullit mësimor dhe shkencor në të cilin bëhet përzgjedhja.

Konkursi zgjat **pesë (5) ditë pune** nga dita e shpalljes së konkursit, dhe zgjat deri me datë **05.01.2024** Fletëparaqitjen me dokumentet kandidatët duhet ti dorëzojnë në hapësirat e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, rr. ”1669”, nr. 11A (ish Kazerma Ilinden), me dedikim: Për konkursin për zgjedhje të mësimdhënësit në të gjitha thirrjet mësimore shkencore, thirrje akademike (thirrje të titulluar), në:

- A. Fakultetin Juridik**
- B. Fakulteti i Shkencave Teknologjike**
- C. Fakulteti i Shkencave Sociale**

**pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup**

Dokumentet jo të kompletuara dhe ata që nuk i dorëzojnë në kohën e duhur nuk do të shqyrtohen.

Me respekt,  
Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup